

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 493 Rep.

Nr. 98 Kol. /7

DËSHMI TRASHËGIMIE LIGJORE

NOTER: LORIANA A. ROBO

Sot, më datën 14 shkurt 2017, unë Lorian A. Robo, noter i Dhomës së Noterisë Tiranë, me zyrë në rrugën "Ismail Qemali", P. 27/1, Tiranë mora në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur prej:

KËRKUES: **Z. Hasan (Teki) Hodaj**, lindur në Dames, Fier, me 04.07.1963, banues ne Rruga T. Shkurti, Tirane, me nr. personal G30704150W.

OBJEKTI: Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin **Teki (Selfo) Hodaj**.

BAZA LIGJORE: Neni 348 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Neni 53 i Ligjit "Për Noterinë", i ndryshuar.

Unë Noteri, pasi administrova provat shkresore,

V Ë R E J:

Se kërkuesi, Hasan Hodaj, ka depozituar më datë 6 shkurt 2017, në këtë zyrë noteriale, një kërkesë me anë të së cilës kërkohet: "*Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin Teki (Selfo) Hodaj*".

Nga dokumentet e depozituara nga kërkuesi me dosjen (konkretisht: kërkesë për lëshimin e trashëgimisë ligjore për të ndjerin Teki (Selfo) Hodaj datë 6 shkurt 2017, çertifikatë vdekje, çertifikatë familjare, çertifikata personale të trashëgimtarëve – të administruara nga unë noter), rezulton se:

- Trashëgimlënësi Teki Hodaj, shtetas shqiptar, i biri i Selfo dhe Fatime, i datëlindjes 18.07.1936, lindur në Dames, Fier, i ve, banues në Rr. "T. Shkurti", nr. 145, Tiranë, me numër personal identifikimi D60718041W, ka vdekur në datë 02.02.2017, në shtëpi.

- Trashëgimlënësi nuk rezultoi te këtë lënë testament. Ky fakt vërtetohet edhe nga verifikimi i bërë nga unë Noteri, në Regjistrin Kombëtar të Testamenteve pranë Dhomës Kombëtare të Noterëve.

Nga verifikimi i dokumenteve, rezultoi se trashëgimlënësi Teki Hodaj, i biri i Selfo dhe Fatime, ka lindur më 18.07.1936, në Dames, Fier dhe ka vdekur më datë 02.02.2017 në Tiranë. Ai ka qënë i martuar me Bejaze Hodaj, e bija e Shaban dhe Esma, e lindur më 28.08.1940, në Dames, Fier, me nr. personal E05828050G, e cila ka vdekur në datën 19.07.2016, në Tiranë.

Nga martesë e tyre kanë lindur tre fëmijë, dy djem dhe një vajzë, konkretisht:

- (i) Fiqiri Hodaj, i biri i Teki dhe i Bejaze, lindur më 01.01.1959, lindur në Dames, Fier, banues në Tiranë, Rr. "Todi Shkurti", nr. 145, me nr. Personal F90101076E;
- (ii) Dallandyshe Bidaj, e bija e Teki dhe e Bejaze, lindur më 31.03.1960, në Dames, Fier, banuese në Rrogozhinë, Lgj.1, me nr. personal G05331022D;
- (iii) Hasan Hodaj, i biri i Teki dhe i Bejaze, lindur më 04.07.1963, lindur në Dames, Fier, banues në Tiranë, Rr. "T. Shkurti", me nr. Personal G30704150W.

Sa më sipër provohet nga dokumentet në vijim:

- a. Çertifikatë vdekje e Teki Hodaj, nr. serie 011313910, datë 06.02.2017, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr. 2, Njësia administrative Tiranë 374, në bazë të aktit të vdekjes nr. 73, datë 03.02.2017;
- b. Çertifikatë vdekje e Bejaze Hodaj, nr. serie 011313907, datë 06.02.2017, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr. 2, Njësia administrative Tiranë 374, në bazë të aktit të vdekjes nr. 217, datë 21.07.2016;
- c. Çertifikatë familjare (trungu), nr. serie 011166906, datë 08.02.2017, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Fratar, Njësia Administrative Fratar, nr. 191, në bazë të regjistrit themeltar të vitit 1974, fshati Dames;
- d. Çertifikatë personale e Fiqiri Hodaj, nr. serie 011313557, datë 07.02.2017, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr. 2, Njësia administrative Tiranë 374, në bazë të regjistrit kombëtar të gjendjes civile të vitit 2010;
- e. Çertifikatë personale e Dallandyshe Bidaj, nr. serie 009840544, datë 08.02.2017, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Rrogozhinë, Njësia administrative Rrogozhinë 405, në bazë të regjistrit kombëtar të gjendjes civile të vitit 2010;
- f. Çertifikatë personale e Hasan Hodaj, nr. serie 011975722, datë 06.02.2017, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr. 2, Njësia administrative Tiranë 374, në bazë të regjistrit kombëtar të gjendjes civile të vitit 2010.

Në përputhje me përcaktimet e nenit 348 të Kodit Civil, unë noteri konstatoj se trashëgimlënësi, i ndjeri Teki (Selfo) Hodaj, ka banuar në datën e vdekjes në adresën: Rruga "T. Shkurti", nr. 145,

Tiranë. Bazuar në sa më sipër dhe në përcaktimet e nenit 53, germa a) të Ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë", i ndryshuar, konstatoj se çelja e dëshmisë së trashëgimisë ligjore në fjalë është në kompetencën time vendore.

Pasi u renditen faktet e mësipërme, unë noteri, në bazë të nenit 318 të Kodit Civil, i cili parashikon se *"trashëgimia çëlet në kohën kur vdes trashëgimlënësi dhe në vendin ku ka pasur banimin e tij të fundit.... Ajo rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur"*, përcakton se në rastin në fjalë koha kur çëlet trashëgimia është data e vdekjes së të ndjerit Teki (Selfo) Hodaj dhe pikërisht data 02.02.2017. Prandaj ligji që do të parashikojë rregullimin ligjor për çeljen e trashëgimisë së tij do të jetë ligji në fuqi në atë datë dhe pikërisht Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë në fuqi, miratuar me Ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar (në këtë dokument referuar si "Kodi Civil").

Në bazë të nenit 317 të Kodit Civil të sipërpërmëndur *"trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament..."*. Në rastin në fjalë, meqënëse trashëgimlënësi Teki (Selfo) Hodaj nuk ka bërë testament, për të lëshuar dëshminë e trashëgimisë do të zbatohen dispozitat ligjore të Kodit Civil që rregullojnë trashëgimime ligjore.

Duhet theksuar se që trashëgimtarët ligjorë të përfitojnë nga pasuria trashëgimore duhet së pari që ata të kenë zotësi trashëgimore dhe së dyti të bëjnë pjesë në radhën e trashëgimtarëve ligjorë që në bazë të ligjit u takon pasuria trashëgimore.

Përsa i përket pikës së parë, në bazë të nenit 320 të Kodit Civil, zotësi për të trashëguar *"ka personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë, pra kur ka vdekur trashëgimlënësi, është gjallë..."*

Përsa i përket pikës së dytë, neni 360 i Kodit Civil, parashikon se *"trashëgimtarë ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijëve, bashkëshorti, prindërit,.... Këta thirren në trashëgimi sipas radhës së caktuar në këtë Kod."*; gjithashtu neni 361 paragrafi 1 i Kodit Civil, parashikon se *"nëradhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë apo i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta."*

Nga interpretimi i dispozitave të mësipërme ligjore të Kodit Civil rezulton se kur çëlet trashëgimia ligjore, në radhë të parë përfitojnë fëmijët e trashëgimlënësit në pjesë të barabarta (bashkëshortja Bejaze Hodaj ka vdekur më përpara se i ndjeri bashkëshorti Teki Hodaj, pikërisht në datën 19.07.2016), të cilët janë gjallë në çastin e çeljes së trashëgimisë.

Përsa më sipër në rastin në fjalë, trashëgimtarë të trashëgimlënësit Teki (Selfo) Hodaj, janë fëmijët e tij: Fiqiri Hodaj, Dallandyshe Bidaj dhe Hasan Hodaj, të cilët janë gjallë në kohën e çeljes së trashëgimisë. Ata janë trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë dhe trashëgojnë të gjithë pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit, në pjesë të barabarta. Megjithatë dy nga fëmijët e trashëgimlënësit konkretisht Dallandyshe Bidaj dhe Fiqiri Hodaj, kanë hequr dorë nga trashëgimia, brenda afatit ligjor të heqjes dorë nga trashëgimia, në bazë të deklaratës noteriale me nr. Rep. 377, nr. Kol. 77, të datës

06.02.2017, noterizuar nga noteri nënshkrues. Pra përfundimisht trashëgimtar i vetëm i trashëgimlënësit Teki (Selfo) Hodaj është djali i tij Hasan Hodaj.

PËR KËTO ARSYE


Në bazë të neneve 348 e në vijim të Kodit Civil dhe Neni 53 e në vijim të Ligjit “Për Noterinë”, i ndryshuar, unë Noteri,

VENDOS:

- Pranimin e kërkesës për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin Teki (Selfo) Hodaj.
- Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Teki (Selfo) Hodaj, e cila çelet në datën e vdekjes së tij, pra më datë 02.02.2017.
- Përcaktimin si trashëgimtar të vetëm ligjor të radhës së parë me të gjithë pasurinë trashëgimore, të djalit të tij si më poshtë:

Z. Hasan Hodaj, i biri i Teki dhe Bejaze, i lindur më 04.07.1963, në Dames, Fier, banues ne Tiranë, Rr. T. Shkurti, nr. 145, me nr. personal G30704150W.

- Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit.
- U lëshua, sot në Tiranë, më datë 14 shkurt 2017, në 7 (*shtatë*) kopje.



NOTER


Loriana A. Robo

Loriana Robo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
Nr. 377 Rep.
Nr. 77 Kol. /1

DEKLARATË NOTERIALE



Sot, më datë 06.02.2017 (*dy mijë e shtatëmbëdhjetë*), para meje Noterit, Lorianë A. Robo, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në Rrugën Ismail Qemali, P. 27/1, u paraqitën personalisht:

Z. Fiqiri (Teki) Hodaj, lindur në Dames Fier, më 01.01.1959, me pasaporte franceze nr. 12D166515, banues në Francë, *dhe*

Zj. Dallandyshe (Teki) Bidaj, lindur në Dames Fier, më 31.03.1960, me leternjoftim shqiptar me nr. personal nr. G05331022D, banuese në Lagja nr. 1, Vollga, Durrës,

të dy madhorë e me zotësi të plotë për të vepruar, të panjohur prej meje por që për identitetin e të cilëve u binda nga verifikimi i dokumenteve të tyre të identifikimit personal, të cilët me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë më deklaruan sa më poshtë:

"Ne të nënshkruarit, në cilësinë e trashëgimtarëve të të ndjerit babait tonë Teki (Selfo) Hodaj, *deklarojmë* me vullnetin tonë të lirë dhe të plotë se nuk kemi asnjë pretendim mbi pasurinë trashëgimore të babait tonë të ndjerë dhe për këtë arsye heqim plotësisht dorë nga çdo pasuri që rrjedh nga trashëgimia ligjore e të ndjerit babait tonë Teki (Selfo) Hodaj, lindur në Dames, Fier, më 18.07.1936, me nr. personal D60718041W, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm shqiptar.

Sa më sipër e deklarojmë nën përgjegjësinë tonë personale."

Unë Noteri, pasi dëgjova deklarinimet e bëra prej deklaruesve dhe verifikova dokumentet përkatëse, konstatova se deklarata është në përputhje me vullnetin e lirë dhe të plotë të deklaruesve, gjithashtu edhe konform ligjit, dhe për këtë unë Noteri vërtetoj nënshkrimin e tyre dhe e nënshkruaj këtë akt duke i dhënë forcën e nevojshme ligjore.

Ky akt redaktohet në 4 (*katër*) kopje në gjuhën shqipe.

DEKLARUES

Fiqiri Hodaj

Fiqiri Hodaj

Dallandyshe Bidaj

Dallandyshe Bidaj

